



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
AGJENCIA E SIGURIMIT TË CILËSISË NË ARSIMIN E LARTË
BORDI I AKREDITIMIT

VENDIM

Nr. 37, datë 22.04.2022

PËR
AKREDITIMIN E PARË TË PROGRAMIT TË STUDIMIT TË CIKLIT TË DYTË
MASTER PROFESIONAL NË “KOMUNIKIM MARKETINGU”, TË KOLEGJIT
UNIVERSITAR “BEDËR”

Bordi i Akreditimit, bazuar në Ligjin Nr. 80 datë 17.09.2015 “Për arsimin e lartë dhe kërkimin shkencor në institucionet e arsimit të lartë në Republikën e Shqipërisë”, Ligji Nr. 8480, datë 27.5.1999 “Për Funksionimin e Organeve Kolegjiale të Administratës Shtetërore dhe Enteve Publike”, Ligjin Nr. 44/2015, datë 30.04.2015, “Kodi i procedurave administrative të Republikës së Shqipërisë”, Vendimin e Këshillit të Ministrave Nr. 109, datë 15.02.2017 “Për organizimin dhe funksionimin e Agjencisë së Sigurimit të Cilësisë në Arsimin e Lartë e të Bordit të Akreditimit dhe për përcaktimin e tarifave për proceset e sigurimit të cilësisë në arsimin e lartë”, i ndryshuar, Vendimin e Këshillit të Ministrave nr. 531, datë 11.9.2018, “Për miratimin e Kodit të Cilësisë së Arsimit të Lartë”, Vendimin e Bordit të Akreditimit, Nr.1, datë 07.04.2017, “Për mbylljen e procedurave të mbartura për shkak të riorganizimit të Institucioneve të Sigurimit të Cilësisë në Arsimin e Lartë”, Vendimin e Bordit të Akreditimit, Nr. 2, datë 07.04.2017, “Për përcaktimin e kohëzgjatjes dhe afateve të vlefshmërisë së akreditimit në kuadër të vendimmarrjes për akreditimin e Institucioneve të Arsimit të Lartë dhe Programeve të Studimit” dhe Vendimin e Bordit të Akreditimit, Nr. Ekstra 1, datë 02.02.2018 “Për miratimin e Rregullores së Bordit të Akreditimit”, në mbledhjen e tij të datës 22.04.2022, në kuadër të vendimmarrjes për akreditimin e parë të programit të studimit të ciklit të dytë, Master Profesional në **“Komunikim Marketingu”** me të dhënat si më poshtë:

- a) Emërtimi i programit: Master Profesional në **“Komunikim Marketingu”**
- b) Cikli i studimit: Cikli i dytë
- c) Akti zyrtar i hapjes/licensimit: Urdhër i Ministrit të Arsimit Sportit dhe Rinisë Nr. 351, datë 17.06.2019
- d) Institucioni që e ofron: Kolegji Universitar “Bedër”
- e) Njësia bazë përgjegjëse: Departamenti i Shkencave të Komunikimit
- f) Kohëzgjatja (Vite/semestra): 1 vit/2 semestra
- g) Kredite (ECTS): 60 kredite
- h) Forma e studimit: Me kohë të plotë
- i) Statusi i diplomës: ofrohet vetëm nga Kolegji Universitar “Bedër”
- j) Niveli i diplomës në kuadrin e Kornizës Shqiptare të Kualifikimeve: Niveli 7

pasi mori në shqyrtim:

- a. Dokumentacionin e Vetëvlerësimit, përfshirë të dhënat e programit të studimit;
- b. Raportin e Vetëvlerësimit dhe dokumentacionin mbështetës;
- c. Dokumentacionin e Vlerësimit të Jashtëm, përfshirë Raportin e Vlerësimit të Jashtëm, dhe dokumentacionin shtesë;
- d. Raportimin e Ekspertëve të Vlerësimit në mbledhjen e Bordit;
- e. Vlerësimin e cilësisë në përmbajtje, të kryer nga ekspertët e jashtëm në përbërje të Grupit të Vlerësimit të Jashtëm;
- f. Procedurën e vlerësimit të ndjekur dhe monitoruar nga ASCAL;
- g. Komunikimin e vërejtjet e institucionit në kuadër të këtij procesi;

konstaton se:

- a. Procedura dhe procesi i vlerësimit janë kryer në përputhje me parashikimet ligjore dhe nënligjore dhe afatet e përcaktuara në këto akte;
- b. Vlerësimi në përmbajtje është i mbështetur në Dokumentacionin e Vetëvlerësimit, Vlerësimit të Jashtëm dhe gjetjet e verifikimet gjatë vizitës në institucion;
- c. Raporti është hartuar në përputhje me kërkesat dhe i mbështetur me fakte, të dhëna e dokumentacion plotësues;
- d. Rezultatet e vlerësimit janë nxjerrë në përputhje me gjetjet, pikat e forta e afirmimet dhe pikat e dobëta, të identifikuara e verifikuara përmes dokumentacionit dhe vizitës në institucion;
- e. Rezultati i vlerësimit në lidhje me shkallën e plotësimit të *“Standardeve për sigurimin e cilësisë për programet e studimit të ciklit të dytë “Master Profesional”* dhe cilësinë e ofertës akademike të programit të studimit është **“i përmbush kryesisht standardet”**, me mangësitë si më poshtë:

1. Literatura në gjuhën shqipe, në funksion të këtij programi studimi është e kufizuar dhe e pa përditësuar.

Mbështetur mbi rezultatet dhe arsyetimin e mësipërm, Bordi i Akreditimit,


VENDOSI:

1. Vlerësimin përfundimtar **POZITIV** për programin e studimit **Master Profesional** në **“Komunikim Marketingu”**, të Kolegjit Universitar **“Bedër”**, me rekomandimet sipas shtojcës së këtij vendimi.
2. **Akreditimin** e programit të studimit me kohëzgjatjen prej **5 (pesë) vite**.
3. Afati përfundimtar i vlefshmërisë së akreditimit të programit të studimit është **21/04/2027**.
4. Ngarkohet Agjencia e Sigurimit të Cilësisë në Arsimin e Lartë për zbatimin e këtij vendimi, publikimin dhe lëshimin e certifikatës së akreditimit brenda një muaji nga data e marrjes së këtij vendimi, si dhe monitorimin për ruajtjen në vijim të Standardeve të Kodit të Cilësisë dhe plotësimin e rekomandimeve sipas shtojcës bashkëlidhur.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

BORDI I AKREDITIMIT

SHQIPONJA TELHAJ



Kryetare

ALEXANDER KOHLER




Anëtar

AYŞEN SAVAŞ SARGIN



Anëtar

TOMASZ JELENSKI



Anëtar

IRAJ HASHI



Anëtar

MAURICE OUDEJANS



Anëtar

LEA YPI




Anëtar

KITA SALLABANDA DIAZ



Anëtar

DARINKA PIQANI



Anëtar

DRITAN NAÇE



Anëtar

INDRIT HOXHA



Anëtar

Shtojca

Rekomandimet në zbatim të vendimit të Bordit të Akreditimit Nr. 37, datë 22.04.2022, “Për akreditimin e parë të programit të studimit **Master Profesional** në “**Komunikim Marketingu**”, të Kolegjit Universitar “Bedër”, janë si vijon:

1. Institucioni, të pasurojë e përditësojë fondin e literaturës në gjuhën shqipe, në funksion të realizimit me sukses të këtij programi studimi.
2. Institucioni, të vijojë përpjekjet për angazhimin në këtë programi studimi të personelit akademik të kategorisë Profesor.
3. Institucioni, të rrisë promovimin e këtij programi studimi, me qëllim tërheqjen edhe të studentëve shqipfolës jashtë territorit të Shqipërisë.
4. Institucioni, të inkurajojë më shumë lëvizshmërinë e studentëve të këtij programi studimi, në universitetet e huaja, si një mënyrë për të zvogëluar ndikimin e krijuar nga pandemia Covid-19, duke rritur pjesëmarrjen në projekte ndërkombëtare.

Në përmbushje të rekomandimeve të mësipërme, **Kolegji Universitar “Bedër”**, duhet të hartojë një Plan Veprimi konkret dhe ta dorëzojë atë brenda 6 (gjashtë) muajve pranë Agjencisë së Sigurimit të Cilësisë në Arsimin e Lartë.

Ngarkohet ASCAL për ndjekjen e përmbushjes së këtyre rekomandimeve dhe raportimin në BA brenda afatit të përcaktuar në Planin e Veprimit.

